



*PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT*

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri,  
Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja e dt. 04.09.2007

Salla: N-225 ora 10.001

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.

**Procesverbal**

Morën pjesë: Ibush Jonuzi - kryetar, Bajrush Xhemaili, Mahir Yagcillar, Ilmi Ahmeti, Zef Morina, Sale Berisha, Milazim Haliti, Hatixhe Hoxha, Brikena Kryeziu, Fadil Gashi, Xhevdet Neziraj ndërsa munguan: Sllagjan Iliq, Vezira Emrush dhe Ylber Hysa.

Prezent ishin edhe të ftuarit: Përfaqësuesit e MTPT-së, si dhe përfaqësuesit e NDI-as.-

Mbledhjen e drejtoi Ibush Jonuzi – kryetar i Komisionit, me këtë

**Rend dite**

1. Miratimi i procesverbaleve
2. Shqyrtimi i vërejtjeve të UNMIK-ut, lidhur me Ligjin për sigurinë e komunikacionit rrugor;
3. Shqyrtimi i Projekt ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët.
4. Të ndryshme.

**Rendi i ditës u miratua.**

1. Miratohen procesverbalet e mbledhjeve të dt. 24.08.07, 27.08.07 dhe të 31. 07.07
2. **Shqyrtimi i vërejtjeve të UNMIK-ut, lidhur me Ligjin për sigurinë e komunikacionit rrugor.**

**Ibush Jonuzi-** i njoftoi të pranishmit me vërejtjet dhe komentet e UNMIK-ut, në Ligjin për sigurinë në komunikacionit rrugor.

Përfaqësuesi i MTPT-së, lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet të cilat janë propozuar nga zyra Ligjore e UNMIK-ut, tha se janë vërejtje jo përmbajtjesore. Propozimi për ndarje të

Ligjit në dy pjesë –ligje ( Ligjin për Rregullat në komunikacion dhe Ligjin për regjistrimin e automjeteve ) konsiderojë se nuk është i nevojshëm. Ky Ligj duhet të jetë gjithë përfshirës. Ai tha se ministria do t'i shqyrtoi edhe më tej dhe dot përgatis komentet e veta e që dot i dërgoi komisionit sa më parë për shqyrtim.

**Avdi Kamerolli-** duke u bazuar në vërejtjeve dhe sugjerimeve të UNMIK-ut, ai vlerësoi se shumica janë të pa qëndrueshme. Ligji është në përputhje të plotë me aquis--communitë, si dhe i përafërt me legjislacionin e BE-së.

**Ibush Jonuzi-** i njoftoi të pranishmit se zyra ligjore e UNMIK-ut, është ftuar me kohë për pjesëmarrje dhe ofrim të komenteve lidhur me vërejtjet. Mungesa e tyre nuk e ndihmon komisionin për punë të mëtejme. Në duhet të vazhdojmë punën dhe të harmonizojmë ligjin me vërejtjet e UNMIK-ut aty ku ka mundësi.

**Milazim Haliti-** Vërejtji se UNMIK-u ka pasur mundësi që edhe gjatë hartimit të P.ligjit të ofroi ndihmën e vetë e gjithashtu edhe në vërejtjet e veta të ofroi edhe argumente mbështetëse . Ai propozoi që përsëri të ftohet zyra e UNMIK-ut dhe drejtpërdrejtë para komisionit të arsyetoi vërejtjet e veta

**Mahir Yacillar-** edhe ai u pajtua me parafolësit dhe propozoi që të ftohet një përfaqësues nga zyra ligjore e UNMIK-ut.

**Xhevdet Neziraj-** Përfaqësuesit e zyrës ligjore të UNMIK-ut, duhet të ofrojnë argumente lidhur me këto propozim ndryshime e intervenime, pastaj vërejtjet e argumentuara të shqyrtohen me vëmendje.

**Zef Morina-** ligjet e një fushe duhet të jenë sa ma të harmonizuara pra të mos janë në kundërshtim mes veti. Ai propozoi që vërejtjet e dhëna të analizohen. Si pas tij ka vërejtje të cilat meritojnë vëmendje.

**Ilmi Ahmeti-**ky ligj duhet të jetë në harmoni më ligjet tjera,janë disa vërejtje të cilat duhet të korrigjohen.

**Sale Ahmeti-** u pajtua me parafolësit dhe propozoi që gjatë hartimit të ligjeve Ministrinë duhet t'i ftojë edhe përfaqësuesit nga zyra ligjore e UNMIK-ut,me qëllim të harmonizimit sa ma të mirë të ideve dhe mendimeve. Mos harmonizimi gjatë hartimit të ligjeve po reflekton edhe pasoja gjatë procedimit dhe miratimit tyre.

**Brikena Kryeziu-**propozimi rreth ndarjes së ligjit është i vonuar dhe i pa nevojshëm ndërsa për përkufizimet kërkoi që të standardizohen për të gjitha ligjet e një lamie.,

**Hatixhe Hoxha-** u pajtua me të gjitha vërejtjet e parafolësve dhe propozoi që të formohet një grup punues, që të analizojë të gjitha vërejtjet dhe propozimet për këtë ligj.

#### **.Përfundim:**

Për shqyrtimin e vërejtjeve të UNMIK-ut në Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor formohet grupi punues në përbërje prej:

Mahir Yacillar kryetar grupi, Zef Morina, Hatixhe Hoxha,

përfaqësuesi i ministrisë dhe Hasan Tahiri nga departamenti për çështje procedurale e juridike i Kuvendit.

### **3. Shqyrtimi i Projekt ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rrugët.**

**Ibush Jonuzi-** informoi të pranishmit se IDA-ja ka angazhuar Kujtim Kërveshin nga Ministria për Drejtësi që të ofroi ndihmë profesionale gjatë shqyrtimit të këtij P.ligji.

**Skënder Gashi-** konsideroi se ka qenë i domosdoshëm plotësimi i këtij Ligji, tha se disa propozime nuk kanë qenë të precizuara mirë. Me këto ndryshime Ligji do të jetë më i qartë dhe më i zbatueshëm .

**Zef Morina-** Propozojë që të formohet një grup punues që do të shqyrtoi të gjitha propozimet –ndryshimet si dhe vërejtjet nga seanca gjatë leximit të parë dhe vërejtjet që dot dalin nga kjo mbledhje.

**Mahir Yacillar-**pajtohem me propozimin për formimin e grupit punues. Ai përmendi disa qështje me të cilat grupi punues duhet t'i trajtoj si janë: rikonstruimi, neni 16.4, autoriteti i rrugës publike, rrugë urbane, vendbanimi, mirëmbajtja, autostrada, transporti i jashtë zakonshëm.

**Sale Berisha-** duhet trajtuar dhe qartësuar kompetencat ndërmjet nivelit komunal dhe qendror, standardet teknike të rrugës si dhe përafrimit me legjislacionin e BE-së .

**Ilmi Ahmet-** u pajtua me vërejtjet dhe propozimet e parafolësve dhe kishte vërejtje në mos harmonizimin e tekstit të P. ligjit me tekstin e nenit 19 të Ligjit e cila paqartësi duhet sqaruar

**Hatixhe Hoxha-** gjithsesi grupi punues duhet t'i ketë parasysh edhe vërejtjet nga seanca plenare, të bëhet harmonizimi i disa dispozitave përkatëse me Ligjin për shpronësimet, si dhe të definohet nocioni për autostradën.

**Milazim Haliti-** vërejtjet e evidentuara duhet të trajtohen nga grupi punues, dhe për trajtimin e ngritjes së gjobave duhet përqendrim dhe analiza të qëndrueshme. Gjatë shqyrtimit të kundërvajtjeve Ministria duhet të jetë prezentë dhe aktive.

**Fadil Gashi-**duhet të shqyrtohet me vëmendje edhe procedura lidhur me shqyrtimin e kundërvajtjeve sepse në teren ka shumë pa qartësi që kanë të bëjnë me kompetenca për shqiptimin dhe ekzekutimin e dënimeve.

Ibush Jonuzi- tha se të gjitha vërejtjet dhe komentet meritojnë vëmendje andaj edhe propozoi që të formohet një grup punues i cili u miratua.

#### **Përfundim:**

**Formohet grupi punues për shqyrtimin e vërejtjeve të UNMIK-ut lidhur me Ligjin për sigurinë e komunikacionit rrugor, në këtë përbërje:**

**Zef Morina kryetar, Milazim Haliti, Mahir Yacillar, Sale Berisha anëtar, kurse për ndihmë profesionale u zgjodhën: Ajshe Ejupi nga MTT, Kujtim Kërveshi nga MD, Robert Muharremi nga USAID-i dhe Hasan Tahiri nga departamenti ligjor i Kuvendit.**

#### **Të ndryshme**

Për datën 11.09.2007 mbahet dëgjim publik me këtë temë: Shqyrtimi i Projekt-propozimit-Vendimit të Qeverisë- MTPT-së, për shpalljen e hapësirës nëpër të cilën do' t ndërtohet Autostrada “Morinë-Merdarë” zonë me interes të veçantë.

Pjesëmarrës: përfaqësues të Qeverisë, MTPT, MMPH, të Kuvendit komunal të Prishtinës,  
të Obiliqit, të Fushë Kosovës dhe të Drejtoratit për urbanizëm dhe planifikim në Prishtinë.

Kryetar i Komisionit- Ibush Jonuzi

Ibush Jonuzi